



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 205, Datë 10.08.2022

MBI

**SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR APLIKIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 dhe nenit 16, pika 6, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1439/4 prot., datë 08.08.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 180, datë 13.07.2022 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë.
- Në vijim, ERE ka dërguar njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës, i cili është botuar në datat 15.07.2022 dhe 16.07.2022. Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data e fundit 28.07.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 971/7 prot., datë 27.07.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme të Bordit, duke evidentuar dhe dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 971/3 prot., datë 08.08.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi, duke u angazhuar se dokumentacionin e depozituar të skanuar nëpërmjet këtij e-maili do ta depozitojë në ERE zyrtarisht dhe në formën e kërkuar nga ligji. Po ashtu shoqëria ka deklaruar se do të depozitojë dokumentacion shtesë të këtij aplikimi brenda 5 ditëve.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e këtij afati rasti pas rasti, konkretisht:

*3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shume se 30 ditë pune.*

- Afati i vlefshmërisë së licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. përfundon më datë 06.09.2022, ndaj ERE kushtëzohet për të shtyrë afatin e vendimmarrjes deri në afatin e fundit të vlefshmërisë së licencës.
- Me qëllim që të shqyrtohet dokumentacioni i depozituar nga ana e shoqërisë e t’i jepet asaj mundësia për të plotësuar dhe pjesën tjetër të dokumentacionit, vlerësohet shtyrja deri më datë 06.09.2022 i afatit të vendimmarrjes së bordit mbi kërkesën e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijani e vendimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të shtyjë deri më 06.09.2022 afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**